

PSH.nr.82/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Data GISconsulting” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për para kualifikim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve, Planeve hapësinore PZHK dhe hartave zonale Komunale” me nr. të prokurimit: 642-20-6099-2-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Mitrovicë e Jugut”, më datën: 25.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Data GISconsulting” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për para kualifikim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve, Planeve hapësinore PZHK dhe hartave zonale Komunale” me nr. të prokurimit: 642-20-6099-2-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Mitrovicë e Jugut”.

II. VËRTETOHET, Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve, Planeve hapësinore PZHK dhe hartave zonale Komunale” me nr. të prokurimit 642-20-6099-2-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Mitrovicë e Jugut”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Data GISconsulting” SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Data GISconsulting” SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.01.2021 me nr. 82/21, kundër njoftimit për para kualifikim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve, Planeve hapësinore PZHK dhe hartave zonale Komunale” me nr. të prokurimit: 642-20-6099-2-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Mitrovicë e Jugut”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 parag. 1 dhe 2, neni 52 parag. 3 dhe 4, neni 80 parag. 3, si dhe nenin 109 parag. 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nenin 59 parag. 14 të RRUOPP-së, si dhe Rregulloren për parashtrim të ankesës (F03), nenin 3, parag.3.1, nenin 4, parag.4.1.(a,b,c), si dhe nenin 6, parag.6.1.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.02.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e datë: 16.02.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Mitrovicë e Jugut, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të konkursit të projektimit. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër vlerësimit të koncept projektit të prezantuar nga OE me shifrën 2011, i prezantuar nga parashtruesi i ankesës. ofertave në fazën para kualifikuese, përkatësisht parashtruesi i ankesës përmes deklaratës në ankese konteston kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113):

Fillimisht eksperti teknik sqaron se si shkresave te lendes qe disponuam rezulton qe konceptit te projektit te OE me shifrën 1212 është poentuar me larte dhe poentomi sipas dispozitave te paragrafit 5 te nenit 80 te LPP-se është individual sipas bindjes se lire te anëtareve te jurisë veç e veç. Përveç kësaj parashtruesi i ankesës ne ofertën e tij e ka bere te ditur identitetin e kompanisë, përderisa paragrafi 2, i nenit 80 , te LPP-se e ndalon një gjë te tille “...Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë”.

- Si prove se bashku me raport gjeni përshkrimin e emrit te ofertuesit.

Po ashtu Pika 7 e ankesës, pozicioni “Kriteri teknik dhe profesional ne DT”

a) Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues, se kanë një kontratë në realizim "Studimi i vizibilitetit" e cila i plotëson të gjitha kriteret e këtij konkursi të projektimit. Eksperti teknik thekson, se AK ka te drejtë pasi kjo kontratë është ende në realizim (21.10.2020 deri 20.03.2021) kurse në FDT pika 9.1 dhe 9.2 shkruan: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte ose plane të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit. Për nga ngjashmëria mund ti afrohet si kontratë por pasi nuk është ende e përfunduar me sukses nuk mund të pranohet. b) Lidhur me pretendimin e OE ankues, kanë një kontratë të realizuar për “Ndërtimin e GIS ne MRËC Mitrovicë” e cila është komplet e lidhur me përgatitjen e hartave digjitale për Mitrovicën. Eksperti teknik vlerëson, se OE ka të drejtë pasi kjo kontratë ka ngjashmëri me punimin e hartave zonale sidomos te katër pikat e pjesës “Aneksi 1. Specifikimet teknike dhe/ose estetike të detyrueshme” në FDT ku lidhet mjaft shumë me trajnimet, GIS-in dhe mbledhjen e përpunimin e bazës së të dhënave.

c) Lidhur me pretendimin e OE ankues, se kanë një kontratë "Intervistimi dhe Grumbullimi i të Dhënave Statistike nga Terreni" e përfunduar në muajin korrik 2018, e cila ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave statistikore sociale-ekonomike. Eksperti teknik vlerëson, se qëndron pjesërisht pretendimi me rreth 30% të ngjashmërisë me tenderin në fjalë pasi e përbën vetëm një fazë të përgatitjes së hartës zonale, ku është vetëm grumbullim i disa të dhënave nga intervistimi i popullatës në terren ku nuk nevojitet ndonjë staf profesional apo inxhinierë të diplomuar.

d) Lidhur me pretendimin e OE ankues, se kanë një kontratë "Master Plani i ujërave të zeza", e cila i plotëson te gjitha kriteret e këtij konkursi të projektimit.

Eksperti teknik thekson, se te kjo kontratë si shërbime konsulentë nuk ka mjaftueshëm sqarime se çfarë punë duhet të kryhen por sipas emrit të kontratës shihet që ka sadopak ngjashmëri pasi ka të bëjë me analizën dhe mbledhjen e të dhënave dhe futjen e tyre në ndonjë program të GIS-it.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/ teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe ti lejohet AK-se që të procedoj tutje me aktivitet të prokurimit.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 16.02.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 18.02.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik "Data GISconsulting" SH.P.K-Prishtinë, me datë 19.02.2021 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.02.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të ankesës së OE ankues "Data GISconsulting" SH.P.K-Prishtinë, sqaron se pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër vlerësimit të konceptit të projektit të prezantuar nga OE me shifrën 2011, i prezantuar nga parashtruesi i ankesës të ofertave në fazën para kualifikuese, përkatësisht parashtruesi i ankesës përmes deklaratës në ankesë konteston kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se konceptit të projektit të OE me shifrën 1212 është poentuar më lartë dhe poentimi sipas dispozitave të paragrafit 5 të nenit 80 të LPP-së është individual sipas bindjes së lirë të anëtarëve të jurisë veç e veç. Përveç kësaj, parashtruesi i ankesës në ofertën e tij e ka bërë të ditur identitetin e kompanisë, përderisa paragrafi 2, i nenit 80 të LPP-së e ndalon një gjë të tillë "....Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë".

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se kanë një kontratë në realizim "Studimi i vizibilitetit" e cila i plotëson të gjitha kriteret e këtij konkursi të projektimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se AK ka të drejtë pasi kjo kontratë është ende në realizim (21.10.2020 deri

20.03.2021) kurse në FDT, pika 9.1 dhe 9.2 shkruan: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte ose plane të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit. Për nga ngjashmëria mund ti afrohet si kontratë por pasi nuk është ende e përfunduar me sukses nuk mund të pranohet.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se kanë një kontratë të realizuar për "Ndërtimin e GIS ne MRWC Mitrovicë" e cila është komplet e lidhur me përgatitjen e hartave digjitale për Mitrovicën, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik vlerëson se OE ka të drejtë pasi kjo kontratë ka ngjashmëri me punimin e hartave zonale sidomos te katër pikat e pjesës "Aneksi 1. Specifikimet teknike dhe/ose estetike të detyrueshme", që në FDT lidhet mjaft shumë me trajnimet, GIS-in dhe mbledhjen e përpunimin e bazës së të dhënave.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se kanë një kontratë "Intervistimi dhe Grumbullimi i të Dhënave Statistikore nga Terreni" e përfunduar në muajin korrik 2018, e cila ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave statistikore sociale-ekonomike. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik vlerëson se qëndron pjesërisht pretendimi me rreth 30% të ngjashmërisë me tenderin në fjalë pasi e përbën vetëm një fazë të përgatitjes së hartës zonale, ku është vetëm grumbullim i disa të dhënave nga intervistimi i popullatës në terren, ku nuk nevojitet ndonjë staf profesional apo inxhinierë të diplomuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se kanë një kontratë "Master Plani i ujërave të zeza", e cila i plotëson të gjitha kriteret e këtij konkursi të projektimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se te kjo kontratë si shërbime konsulentë nuk ka mjaftueshëm sqarime se çfarë punë duhet të kryhen por sipas emrit të kontratës shihet që ka sadopak ngjashmëri pasi ka të bëjë me analizën dhe mbledhjen e të dhënave dhe futjen e tyre në ndonjë program të GIS-it.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, sqaron se autoriteti kontraktues gjatë përgatitjes së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka vepruar në harmoni me nenin 7 të LPP-së sepse gjatë shqyrtimit të ankesës nuk është hasur në elemente të diskriminimit apo favorizimit. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues duke marrë për bazë sqarimet e ekspertit teknik, vlerëson se AK ka përcaktuar kritere të matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit, të cilat mund të shfrytëzohen për vlerësim. Andaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, AK mund të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Mitrovicë e Jugul";
- 1x1 OE "Data GISconsulting" SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.